



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:258283  
Datë: 08.12.2023  
Numri i dokumentit: 05037086

C-IV-14-5931

*Ankuesja*

**R K**, fshati G e U, Graçanicë.

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP)**, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55,  
Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e ankueses konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 22 gusht 2014, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN080-0368 të datës 30 korrik 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 15,000.00 €, per periudhën e pacaktuar nga N.SH Industria e tekstilit “Kosova Tex” (në likuidim).

Me 16 tetor 2023, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesen mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesja u informua se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja e lartë cekur së bashku me urdhërpagesë i është dorëzuar ankueses me 20 tetor 2023 dhe gjer me datën e lëshimit të këtij aktvendimi taksa gjyqësore nuk është paguar.

## **Arsyetimi ligjor**

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesja konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 16 tetor 2023, gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesja, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr nëse ajo nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankueses i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesja ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga ankuesja me datë 20 tetor 2023, mirëpo ajo nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## **Shpenzimet Gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar